



D.P. 03-2505/11  
12.04.2011

**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ ÒPSTENSKI SUD ZA PREKRËAJE U**  
**PRISHTINU/MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA**

Nr.regj: ~~4000~~ 33958/10 /10

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Sabit Gashi nga fsh, Arllat/Drenas, për kundërvajtje nga neni 16 par. 1.2 të Ligjit për Deklarimin, prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të ardhurave të Zyrtare të Lartë Publik, e në bazë të nenit 73.74 dhe nenit 198 al.1 pika 1 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më datë 22.11.2010 merr këtë:

**A K T V E N D I M**

**PEZULLOHET** procedura kundërvajtëse ndaj të pandehurit Sabit Gashi, Ushtrues i detyrës së Drejtorit të Departamentit të Energjisë dhe Minierave. Për kundërvajtje nga neni 16 par. 1.2 të Ligjit për Deklarimin, prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të ardhurave të Zyrtare të Lartë Publik.

Procedura pezullohet konform nenit 198 al.1 pika 1 të LMK-së, pasi që me veprimet e të pandehurit nuk elemente të kundërvajtjes, pasi që me veprimet e të pandehurit nuk ka elemente të kundërvajtjes, sepse i pandehuri është Ushtrues i detyrës së Drejtorit të Departamentit të Energjisë dhe Minierave dhe nuk ka qenë i informuar, as nuk ju ka dorëzuar formulari për deklarimin pasurisë. Si dhe në momentin kur ai është informuar për obligimin për deklarimin e pasurisë e ka deklaruar pasurin kopja e së cilës gjindet në shkresat e landës. Nga një kopje e këtij aktvendimi t'i dërgohet të pandehurit dhe parashtruesit të kërkesës.

**A r s y e t i m**

**Agjencia kundër Korrupsioni në Prishtinë**, parashtron kërkesën 01-3497/10 të datës 25.10.2010 për ngritjen e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit të cekur më lartë dhe për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjyqtarja zhvilloi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të pandehurin, i cili deklaroi se është ushtrues i detyrës së Drejtorit të Departamentit të Energjisë dhe Minierave dhe për këtë nuk e kam ditur se edhe unë duhet të deklaroj pasurin, pasi as në ligj nuk është e cekur e edhe u.d. janë të detyruar ta deklarojnë pasurin, e në të njëjtën kohë nuk jam njoftuar e as nuk kam pranuar aplikacion nga e eprori im për deklarimin e pasurisë. Por meqenëse tani e kam kuptuar se jam i obliguar ta deklaroj pasurin atë e kam bërë, kopja e së cilës gjindet në shkresat e landës, andaj Gjyqtari konform nenit 198 al.1 pika 1 të LMK-së, PEZULLOI procedurën kundërvajtëse pasi që me veprimet e të pandehurit nuk ka elemente të kundërvajtjes. Me sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, ankesë mund të parashtrrojë i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës në afatin prej 8 ditësh, pasi që ky aktvendim të merr formën e prerë. Ankesa i parashtrohet Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate dhe pa pulla.

**VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**

